



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË
KËSHILLI BASHKIAK KUÇOVË

**MBLEDHJET E KOMISIONEVE TË KËSHILLIT BASHKIAK KUÇOVË SIPAS
RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E RADHËS TË MUAJT MAJ 2022**

Axhenda e Komisioneve

Komisionit të Bujqësisë, pyjeve, menaxhimit të ujërave, mbrojtjes së mjedisit dhe biodiversitetit, ditë e **Hënë**, datë **23 Maj 2022**, ora **14:00**, vendi **Zyra e Sekretares së Këshillit**, kati III, Bashkia Kuçovë, Kryetari i Komisionit z. Saimir Sado me axhendën si më poshtë:

- **Projekt-vendim:** “Mbi miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjore-kullota”.
- **Informacion:** “Informacion për situatën aktuale të tregut të fruta-perimeve, cilësia e produkteve për konsumatorin dhe sasia e pesticideve në produktet e shportës ushqimore, inspektimet e kryera nga ana juaj dhe rezultatet e dala”.
- **Informacion:** “Informacion mbi gjëndjen dhe masat e marra për kanalet vaditëse në njësitë Administrative të Bashkisë Kuçovë”.

Komisionit të Shërbimeve publike, transportit, lëvizshmërisë mjedisore, parqeve dhe rekreacionit, parkingjeve, ditën e **Mërkurë**, datë **24 Maj 2022**, ora **15:00**, vendi **Zyra e Sekretares së Këshillit**, kati III, Bashkia Kuçovë, Kryetari i Komisionit z. Erion Coka me axhendën si më poshtë:

- **Projekt-vendim:** “Miratimin për një ndryshim në VKB nr.53, datë 25.06.2020 me objekt: Të miratojë masën e dëmshpërblimit për shpronësimet e qytetarëve pronarë që janë prekur nga zbatimi i projektit të zgjerimit të varrezave publike Kuçovë, i ndryshuar”.
- **Informacion:** “Informacion mbi punën e bërë nga Agjensia e Shërbimeve Komunale mbi mbjelljen e fidanëve të rinj për shtimin e gjelbërimit si dhe masat e marra për riparimet e rrugëve në të gjithë territorin e Bashkisë Kuçovë”.

- **Informacion:** “Informacion për situatën aktuale të rrugëve rurale, veçanërisht për rrugët e fshatit Havaleas, rrugën lidhëse Gegë-Drizë dhe Lumas dhe masat e që do të ndërmeren për përmirësimin e këtyre rrugëve”.
- **Informacion:** “Informacion mbi masat e marra që tregu i shumicës së fruta-perimeve, të mos kthehet në burim aksidentesh për banorët e qytetit”.

Materiali gjendet dhe në faqen Web: www.bashkiakuove.gov.al